



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 03.03.2025

Nr: 227

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN
NR. 47 ID, DATË 24.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË
QENDRËS “QËNDRESA QYTETARE”**

Sot më datë 03.03.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Qendra “Qëndresa Qytetare”

SUBJEKT: **Zj. Elisa Spiropali**
Kryetar e Kuvendit të Shqipërisë

Z. Bukurosh Maçi
Kryetar i Bashkisë Peqin

Z. Gledian Llatja
Kryetar i Bashkisë Elbasan

Z.Ermal Dredha
Kryetar i Bashkisë Vlorë

Vangjel Tavo
Kyetari i Bashkisë Himarë

OBJEKT: Konstatim e përdorimit të burimeve publike

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator,

Data 03.03.2025

Nr: 227
Ora: 12:00



Fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 47 ID, datë 24.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Qendrës “Qëndresa Qytetare”

KONSTATOJ:

Organizata Qendra “Qëndresa Qytetare” më datë 24.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 47 ID.

Në këtë denoncim Qendra “Qëndresa Qytetare” parashtroi sa vijon: *“Në kuadër të programit KuvendiON, Kryetarja e Kuvendit kanë zhvilluar aktivitete në këto bashki:*

Në bashkitë Berat, Kuçovë, Dimal më datë 22 Tetor 2024;

Në bashkitë Elbasan, Belsh dhe Peqin më datë 28 Janar 2025;

Në bashkitë Himarë dhe Vlorë më datë 11 Shkurt 2025.

Në të tria rastet Kryetarja e Kuvendit sipas me kryetarët e bashkive respektive kanë vizituar institucione të arsimit parauniversitar me konkretisht shkollën 9-vjecare “Meleq Gjozi” Dimal, gjimnazin “Zihni Magani”, Peqin dhe gjimnazin “Spiro Gjikhuri” Himarë. Sipas denoncimeve publike është ndërprerë procesi mësimor me qëllim pjesëmarrjen dhe dëgjuesën e Kryetares së Kuvendit, e cila në fjalimin e saj ka përdorur propagandën politike dhe konkretisht terma si , “votuesit tanë”, “Për inat të Edi Ramës dhe qeverisë, nuk mund t’i biesh Shqipërisë”, “Reformën në drejtësi e kemi bërë me kosto të madhe politike etj. Sa më sipër janë përdorur burimet publike të njësisve qendrore dhe vendore për qëllime elektorale”.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 2, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet e mundshme.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

VENDOS:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Zj. Elisa Spiropali, Kryetar e Kuvendit të Shqipërisë
 - Z. Bukurosh Maçi, Kryetar i Bashkisë Peqin
 - Z. Gledian Llatja, Kryetar i Bashkisë Elbasan
 - Z.Ermal Dredha, Kryetar i Bashkisë Vlorë
 - Z.Vangjel Tavo, Kryetari i Bashkisë Himarë

2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI